



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjencia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

RAPORT MONITORUES

MJEDISI DHE GJINIA

BASHKIA KAMËZ

Nëntor 2022



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Bashkë-financuar
nga Bashkimi Evropian

Bashkë-financuar nga Agjensia
Ndërkombëtare Suedeze për
Zhvillim dhe Bashkëpunim



Sweden
Sverige

Ky Raport monitorues është hartuar në kuadrin e projektit "***Krijimi i Aleancave Lokale Feministe Mjedisore***", që implementohet nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe mbështetet nga Reactor - Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "***Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE***". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe është bashkëfinancuar nga Agjensia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo të Agjensisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Përgatitur nga:

Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

Tabela e Përmbajtjes

BASHKIA KAMËZ	1
HYRJE.....	4
BASHKIA KAMËZ	4
KUADRI LIGJOR	5
STRATEGJIA MJEDISORE	7
ANALIZË E OBJEKTIVAVE DHE PËRMBUSHJA E TYRE NGA BASHKITË.....	7
GJETJET NGA TAKIMET ME KOMUNITETIN	15
KONKLUZIONE	15
REFERENCA.....	17

Hyrje

Gjatë vitit 2022 Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" zhvilloi projektin Krijimi i Aleancave Feministe Lokale dhe Mjedisore. Projekti mbështetet nga "Reactor Research in Action" dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky Aksion financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Projekti kishte për qëllim mbështetjen e organizatave locale të grave në avancimin e kapaciteteve të tyre në gjini dhe mjedis duke përdorur një qasje të "të mësuarit duke bërë" dhe të adresojë në mënyrë efikase çështjet mjedisore nga një perspektivë gjinore.

Për këtë arsye në bashkëpunim me grupet qytetare dhe organizatat lokale, u përqendruam në Kamëz, Pukë dhe Vlorë. Gjatë ciklit të projektit, më shumë se 400 gra dhe vajza u bënë pjesë e takimeve të roganizuara për advokacinë mjedisore; më shumë se 60 të rinj u trajnuan mbi gjininë dhe mjedisin dhe rreth 50 zyrtarë të pushtetit vendor u bënë pjesë e takimeve tona. Tre Aleanca Mjedisore Feministe Lokale u ngritën, duke u bërë kështu zëri i grave dhe vajzave në të tre bashkitë për advokimin e çështjeve mjedisore dhe lidhjen e tyre me mjedisin.

Në vijim, organizatat partnere monitoruan bashkitë respektive dhe dolën me këtë raport monitorues sa i përket situatës aktuale në Pukë, Vlorë dhe Kamëz me qëllim përmirësimin e treguesve mjedisorë në secilën prej bashkive, veçanërisht në fushën e menaxhimit të mbetjeve, ndotjes dhe riciklimit.

Bashkia Kamëz

Bashkia e Kamzës përbëhet nga dy njësi administrative, Kamza dhe Paskuqani. Ajo kufizohet në veri, lindje dhe jug me Bashkinë Tiranë, në veri-perëndim me bashkinë Krujë dhe në perëndim me bashkinë Vorë. Zona e Kamzës ka qenë e përcaktuar si komunë, ku përpara lëvizjeve të mëdha demografike të ndodhura pas viteve 1990, ajo numëronte rreth 6000 banorë. Zona e Kamzës është përcaktuar si bashki për të parën herë në vitin 1996, e cila në vitet në vazhdim ka pësuar një rritje eksponenciale¹. Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia Kamëz numëron 125,632 banorë, ndërkohë sot mendohet që shifra të ketë arritur në 145.500 banorë. Sipërfaqja territoriale e bashkisë Kamëz është 37.18km², ndërsa sipas regjistrimit civil densiteti i popullsisë është 3379 banorë/km². Sipas këtyre të dhënave, Bashkia Kamëz është bashkia me sipërfaqën më të vogël territoriale dhe me densitetin më të lartë të popullsisë në Shqipëri.

Si një zonë e re urbane dhe me densitet të lartë të popullsisë, zhvillimi i infrastrukturës së duhur për ujësjellës, kanalizime, rrugë, sheshe publike apo parqe si dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve, çerdheve e qendrave shëndetësore janë sfidat kryesore të bashkisë Kamëz. Pjesa më e madhe e qytetarëve të Kamzës janë të punësuar ose arsimuar në Tiranë, ku një problem i konsiderueshëm i banorëve të zonës është edhe mungesa e lidhjeve të

¹ <https://pushtetivendor.reporter.al/profili-i-bashkise-kamez/>

përshtatshme të transportit publik me bashkinë Tiranë si dhe lidhjet e dobëta infrastrukturore me kryeqytetin. Bashkia Kamëz ndahet nga Tirana nga lumi i Tiranës por mbi këtë lumë ka një numër shumë të vogël urash të ndryshme të cilat e shtyjnë të gjithë trafikun përmes Kthesës së Kamzës duke krijuar një distancë të konsiderueshme dhe të panevojshme me kryeqytetin.

Qëllimi i bashkisë Kamëz për mjedisin:

Qëllimi i bashkisë Kamëz në sektorin e mjedisit mbetet zhvillimi i qëndrueshëm social dhe ekonomik duke marrë parasysh mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja dhe degradimi, përmes menaxhimit të integruar dhe përmirësimin e vlerave mjedisore. Qëllimi mjedisor është i bazuar në parimin e zhvillimit të integruar, mbrojtjen dhe rritjen e burimeve mjedisore, si dhe sigurimin e rritjes ekonomike dhe prosperitetit social. Për të siguruar integritetin e zonave ekologjikisht të ndjeshme dhe ruajtjen e biodiversitetit në të ardhmen, bashkia Kamëz është angazhuar në:

- Krijimin e një sistemi informacioni për mbrojtjen e burimeve natyrore,
- Zhvillimi i rolit të burimeve mjedisore dhe natyrës në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së banorëve të qendrave urbane, duke lidhur qytetet me zonat natyrore,
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore për të mbështetur zhvillimin ekonomik në të gjitha fushat, p.sh. bujqësi, pylltari, peshkim, gurore, energji, industri, shërbime, turizëm etj,
- Krijimi i rrjetit evropian Natura 2000 për mbrojtjen e zonave ekologjikisht të ndjeshme dhe ruajtjen e peizazheve të vlefshme natyrore,
- Rritja e pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes dhe integrimi i planifikimit hapësinor në vend.

Kuadri Ligjor²

Kuadri Ligjor për vetqeverisjen vendore, i targeton bashkive përgjegjësi edhe në çështjet mjedisore:

Në varësi të kuadrit ligjor nr 139/2015³, për **ligji i Vetëqeverisjes vendore**, nenet që mbulojnë përgjegjësinë juridike të institucioneve mbi mbrojtjen e mjedisit.

Neni 23: Bashkia ushtron funksionin publik për të garantuar infrastrukturën e duhur të shërbimeve publike në: prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; menaxhimin e plotë të ujërave të ndotura, dhe të ujërave të shiut duke siguruar mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.

² Kuadri ligjor i përmbledhur (që vesh me përgjegjësi bashkitë)

³ https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Neni 26: I targeton Bashkive përgjegjësinë mbi sigurimin e masave mbrojtëse për cilësinë e ajrit, tokës, dhe ujit nga ndotja, por gjithashtu dhe marrjen e masave mbrojtëse nga ndotja akustike. Më tej, bashkitë kanë detyrim të zhvillimit të aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, rreth çështjeve të mbrojtjes së mjedisit.

Neni 27: Bashkitë kanë përgjegjësi në administrimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të zotëruar në pronësi të tyre sipas ligjit. Bashkitë ndërmarrin administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore dhe burimeve të kategorive të tjera. Bashkia garanton krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe të këshillimit bujqësor e rural. Bashkia ndërmerr nismën e krijimit dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas ligjit. Bashkia krijon dhe administron skemat vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, duke garantuar akses të balancuar gjinor.

Nga ana tjetër gjendet edhe një kuadër ligjor kombëtar mbi mjedisin, i përmbledhur si më poshtë:

- Ligj Nr.10 431⁴, datë 9.6.2011 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij
- Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”. VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja”.
- Ligji nr.8906, datë 06.06.2002 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- Ligji nr.9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ndryshuar me Ligjin nr. 69/2014.
- Ligji nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”. 5.1 VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin evropian”.

LIGJ Nr 10 431 datë 9.6.2011 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

- *KA SHFUQIZUAR: Ligjin nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e mjedisit” (i përditësuar), i ndryshuar*
- LIGJ Nr. 10 448, datë 14.7.2011 PËR LEJET E MJEDISIT
- I ndryshuar me: ligjin nr.44/2013
- ligjin 60/2014, i përditësuar
- LIGJI Për burimet e rinovueshme 138/2013 (I përditësuar)
- I Ndryshuar me:ligjin nr. 26, datë 20.3.2014
- Ligji nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për Transportet rrugore” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 8908, datë 06.06.2002
- Ligjin Nr. 9096, datë 03.07.2003

⁴ <https://portavendore.al/cbenbashkia/mbrojtja-e-mjedisit/>

- Ligjin Nr. 9373, datë 14.04.2005
- Ligjin Nr. 9760, datë 21.06.2007
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ligjin Nr. 10 302, datë 15.7.2010
- Ligjin nr. 21/2013, date 14.2.2013 FZ 29
- Ligjin nr.37/2014, date 10.4.2014 FZ 63
- Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007 “Për Turizmin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9930, datë 09.06.2008
- Ligjin 76/2013 datë 14.2.2013 fz 31
- Ka Shfuqizuar: Ligji nr. 7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002, “Për Zonat e mbrojtura” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9868, datë 04.02.2008
- Ligji nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për Shërbimin e mbrojtjes së bimëve” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 9908, datë 24.04.2008
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr. 7662, datë 19.1.1993 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve
- Ligji nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për Mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ka Shfuqizuar: Ligjin nr.7707, datë 17.5.1993 “Për mbrojtjen nga zjarri”
- Ligji nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për Administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”. (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligjin Nr. 10 137, datë 11.5.2009
- Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (I përditësuar)
I Ndryshuar me:
- Ligj nr. 32/2013 datë 14.2.2013 FZ 30
- Ligj nr. 156/2013, date 30.5.2013, FZ 172
- Ka Shfuqizuar:
- ligjin nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin e mbetjeve të ngurta”
- ligjin nr. 9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”

Strategjia mjedisore

Analizë e objektivave dhe përmbushja e tyre nga bashkitë

Në varësi të Planit Strategjik Kombëtar, bashkia Kamëz është pjesë e rajonit Tiranë-Durrës, e cila bazuar në planin e integruar ndërsektorial, ku prioritet është zhvillimi territorial për

cilësinë e jetës urbane dhe investimi i një ekonomie me fokus teknologjinë dhe inovacionin. Zhvillimi demografik i parashikuar për Bashkinë Kamëz e përcakton atë si një zonë terciare në planin kombëtar territorial, duke zgjeruar hapësirën për investime të rëndësishme në shërbimet arsimore, social-ekonomike, dhe shëndetësore.

Sipas Planit Kombëtar, Bashkia Kamëz është e përqëndruar të zvogëlojë rrezikun nga përmbytjet lumore, si dhe të rikonceptojë zhvillimin urban pranë tyre, duke patur parasysh rritjen e rolit të mjedisit në zhvillimin e cilësisë së jetës urbane⁵:

- Zvogëlimi i rrezikut nga përmbytjet lumore, nëpërmjet rikonceptimit të strukturave mbrojtëse duke konsideruar zhvillimet e reja urbane pranë lumenjve dhe grykëderdhjeve të tyre.
- Rritja e rolit të mjedisit në zhvillimin ekonomik të vendit; integrimi i sistemit natyror në vlerën ekonomike të sektorëve të zhvillimit.
- Rritja e rolit të mjedisit në cilësinë e jetës urbane përmes promovimit dhe krijimit të aksesit të përshtatshëm ndaj zonave natyrore. (Parandalimi i shpërhapjes urbane).
- Plotësimi i qëndrueshëm i nevojave për ujë, nëpërmjet rehabilitimit dhe modernizimit të sistemeve ujitës.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Bashkia Kamëz në përmirësimin e gjëndjes mjedisore dhe mbrojtjes së saj, do të fokusohet në zvogëlimin nga rreziku i përmbytjeve lumore, si dhe rritjen e rolit të mjedisit në cilësinë e jetës, duke rikthyer aksesimin e zonave të natyrore.

Lumenjtë që përshkrojnë territorin e Kamzës, Lumi i Tiranës, Lumi i Lanës, dhe Lumi i Tërkuzës, përbëjnë element natyrorë të rëndësishëm ku ruajtja e biodiversitetit duhet marrë në konsideratë. Bashkia Kamëz ka një rrjet hidrik që përshkohet nga 3 lumenj, por cilësia e ujërave të tyre paraqitet problematike. Këto lumenj janë të rrezikuar nga ndotës të jashtëm, të cilët zgjedhin të zbarkojnë në mënyrë të paligjshme mbetjet e tyre. Në ndotjen e ujërave sipërfaqësore rol kryesor luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, industriale dhe bujqësore, që janë dukuri të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujrave të lumenjve, dhe të mjedisit në përgjithësi.

Paraqitje e buxhetit të bashkisë Kamëz për investime që i takojnë sektorëve të mjedisit

Në planifikimin e buxhetit për vitin 2022, Bashkia Kamëz është fokusuar më së shumti në ndërtimin e infrastrukturave të nevojshme për kontrollimin e derdhjes së ujrave të zeza dhe të ndryshme. Programi i Mjedisit për 2022 ka për qëllim të përmirësojë kushtet aktuale për zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe reduktimit të faktorëve ndotës. Politikat e parashikuara kanë si nismë të përfshijnë mjediset natyrore si qendra të integruara për aksesin e qytetarëve me funksion kulturor dhe social.

⁵ [VSM relacioni-paraprak.pdf \(kamza.gov.al\)](#)

Për sa i përket zonave bujqësore, synimi është të ndërmerret një proces rehabilitues i tyre me kosto minimale, duke ndaluar investimet infrastrukturore në territorin e parashikuar për investime agrokulturore, ku objektivat janë: Krijimi, plotësimi, përditësimi i regjistrit të pronave bujqësore.

Për të minimizuar impaktin e hedhjes së mbetjeve të paligjshme në lumenj, por dhe nxitjen e moskryerjes së sjelljeve deviante nga ana e konsumatorëve dhe bizneseve, bashkia Kamëz ka ndërmarrë në buxhetin e vitit 2022 nismat e menaxhimit të mbetjeve, menaxhimin e ujrave të zeza, si dhe ndertimet e kanaleve të ujrave të ndotura.

Ndër burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore në terrenin e kësaj bashkie janë shkarkimet urbane, që përmbajnë lëndë organike, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, të cilat favorizojnë procesin e eutrofikimit, bakterie dhe viruse patogjene, metale të rënda si dhe lëndë që prishin pamjen e ujërave dhe u japin atyre ere të keqe.




Figura 1: Peshë në buxhet e nismave që ruajnë cilësinë mjedisore⁶.

Të dhënat e mësipërme korrespondojnë në peshën që programet e përmendura kanë në buxhetin vjetor të Bashkisë Kamëz, respektivisht në shpenzimet e kryera deri në 8-mujorin aktual.

Menaxhimi i mbetjeve

Për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, bashkia Kamëz ka dedikuar, deri në gusht të 2022, 2.8% të buxhetit të shpenzuar, ose shprehur në shifra 75.662.507 lekë. Treguesit e performancës raportojnë që në bashkinë Kamëz janë në total 601 kazanë plehrash, të cilat mbulojnë 97% të popullësisë në zonën administrative, shoqëruar me 13 makineri pastrimi të cilat kryejnë 1 frekuencë ditore të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane në qytet.

Gjithashtu, një problematikë që nxit pasojë mjedisore është dhe ngërçi i ngritur ndërmjet bashkisë Kamëz, Ministrisë së Mjedisit, dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për çështjen e

⁶ <https://kamza.gov.al/viti-2022/>

ngritjes së një landfilli të ri të grumbullimit të mbetjeve në zonën e fshatit Valias për ti shërbyer nevojave të Bashkisë Kamëz. Bashkia Kamëz gjeneron çdo vit rreth 79 825 tonë mbetje⁷. Këto mbetje janë të destinuara për tu dërguar në landfillin e Sharrës, por jo të gjitha arrijnë në destinacionin final.

Në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, qeveria shqiptare është përgjegjëse për të ngritur grupe ndërinstitucionale me qëllim përafriminin e legjislacionit me parimet e BE. Kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimaterike” është një ndër kapitujt më të rëndësishëm të acquis të BE, ku Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, sëbashku me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, strukturat inspektuese, dhe institucionet e tjera të pavaruara, iu delegohen përgjegjësi mbi ushtrimin e kompetencave në fushën e mjedisit dhe në nënfushat përkatëse të tij, si : raportimin periodik të gjëndjes mjedisore, planifikimin e politikave, strategjitë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Ndërkohë, bashkitë janë kryesisht përgjegjëse për operimin e shërbimit të pastrimit, mbledhjen dhe transportin e mbetjeve në pikat e grumbullimit. Bashkitë mund të ngrenë dhe të operojnë qendra me interes vendor për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, përfshirë mbetjet e vëllimshme, mbetjet e riciklueshme dhe mbetjet e biodegradueshme. Në mënyrë të veçantë, “grumbullimi, transportimi, asgjësimi dhe trajtimi i mbetjeve bashkiake” është përcaktuar si një funksion “i veti” i bashkive.

Sipas këtij përkufizimi, bashkitë kanë të drejtë dhe përgjegjësi, për: - organizimin për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, transportimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve bashkiake; - ndërtimin, pronësinë dhe operimin e objekteve të trajtimit; - vendosjen e tarifave të shërbimit për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimit dhe mbledhjen e të ardhurave; - organizimin dhe shpërndarjen e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në vetë bashkinë dhe/ose në bashkëpunim me një ose më shumë bashki të tjera, duke përdorur të gjitha instrumentet ligjore dhe administrative.

Aktualisht, bashkia Kamëz nuk ka një plan lokal për menaxhimin e integruar të mbetjeve. Hartimi i politikave lokale për të rregulluar kuadrin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në bashki, si dhe shërbimet, është një prioritet themelor i cili nuk ka marrë jetë akoma. Menaxhimi i mbetjeve raportohet të jetë në nivele të ulta, teska sisteme grumbullimi miks ka vetëm në zonat qendrore. Ndarja në burim e mbetjeve nuk realizohet aspak në praktikë. Sado që kuadri ligjor i përafrohet parimeve dhe kërkesa të BE-së, shumë prioritete mbeten në letër për shkak të mugesës në investime dhe burime njerëzore.

Menaxhimi i ujrave të zeza

Për menaxhimin e ujrave të zeza, politika e bashkisë Kamëz synon të ofrojë standarde cilësore në aksesin e shërbimeve të KUN si dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve në çdo objekt. Objektivi i këtij programi përqëndrohet mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese

⁷ <https://portavendore.al/2018/11/21/bashkia-kamez-jep-me-koncesion-sherbimin-e-grumbullit-te-mbetjeve-megjithese-nuk-ka-ende-nje-vend-te-percaktuar-si-vend-grumbull-per-to/>

dhe rikonstrukcionin e rrjeteve të dëmtuara. Për këtë program, bashkia Kamëz ka shpenzuar 1.3% të buxhetit të saj, ose thënë ndryshe 35.420.321 leke.

Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të ndotura është një nga programet e politikave që zë më shumë vend në buxhetin e 2022 për bashkinë Kamëz, ku janë shpenzuar 221.900.000 lekë, ose thënë ndryshe 8.2% e buxhetit. Mungesa e kanalizimeve për devijimin e ujrave të zeza drejt burimeve të përshtatshme ka qenë një nga problematikat që kanë prekur më shumë banorët por edhe mjedisin.

Zgjerimi i zonave urbane të paplanifikuara, mungesa e trajtimit të mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza, cenojnë jo vetëm tokat bujqësore, por dhe pasuritë natyrore të rajonit. Kamza është nga ato bashki që kanë pësuar një rritje të menjëhershme dhe të pakontrolluar demografikisht të popullsisë, e cila ka patur ndikim të drejtpërdrejtë dhe në menaxhimin e ujrave të zeza. Ndërtimi i një skeme të largimit të ujrave të zeza duke synuar grupimin e rrjeteve sipas lagjeve/ vendbanimeve, ndërtimi i impianteve dhe gropave septike me standarte do të përmirësonte ndjeshëm ndikimin në mjedis. Po të vihet re, dhe në të dhënat e mëposhtme, ndërtimi i KUN bie në sy ndjeshëm si një nga prioritetet kryesore të menaxhimit të gjëndjes mjedisore, por dhe të normalizimit të qendrave të banuara në bashkinë Kamëz. Duke pasur parasysh rëndësinë e infrastrukturës së ujësjellësit, dhe ujërave të zeza, mirëqenien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të bashkisë Kamëz, padyshim që një politikë e tillë ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kësaj infrastrukture.

Tabela 1: Treguesit e investimeve të Bashkisë Kamëz sipas buxhetit ndër vite

	2022* ⁸	2021 ⁹	2020 ¹⁰
Menaxhimi i ujrave të zeza	75.662.507 l.	86.449.046 l.	178.500.000 l.
Menaxhimi i mbetjeve	35.420.321 l.	74.766.601 l.	97.383.000 l.
Ndertime KUN	221.900.000 l.	455.374.834 l.	178.500.000 l.

**Investimet e kryera gjatë 2022 korrespondojnë vetëm për 8 mujorin e parë të vitit.*

Liqeni i Paskuqanit

Liqeni i Paskuqanit është një prej resurseve më të rëndësishme ujore të Bashkisë së Kamzës. Ai zë një sipërfaqje prej 170 ha dhe aktualisht zona përreth liqenit është zënë nga banesa informale të ndërtuara pas viteve '90, por numri i tyre është i pakët.

⁸ [Monitorimi-8-mujori-2022.doc \(live.com\)](#)

⁹ <https://kamza.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/Raporti-monitorimin-e-zbatimit-te-Buxhetit-per-vitin-2021.pdf>

¹⁰ <https://kamza.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/Kamez-Raporti-Performances-2020-draft-2-12-korrik.pdf>

Liqeni i Paskuqanit gjithashtu është i një rëndësie të veçantë për shkak të pozicionit gjeografik, i cili ndodhet në krah të zgjatimit të bulevardit qëndror të kryeqytetit¹¹. Gjithsesi, biodiversiteti i liqenit së Paskuqanit aktualisht është i cënueshëm ndaj mos funksionimit të kanalit të furnizimit të tij me ujë, ndërtimeve informale përreth, si dhe humbjes së funksionalitetit të tij për të cilin është ndërtuar. Zhvillimi mjedisor, i parashikuar në Strategjinë Kombëtare, fokusohet në zonën më natyrore të territorit të bashkisë, në Paskuqan. Zona e Paskuqanit është propozuar të kthehet në një park urban, zonë rekreative dhe natyrore duke u plotësuar me shërbime të nevojshme.

Cilësia e Ajrit

Ajri në Bashkinë e Kamzës i tejkalon normat e vendosura nga vendi ynë dhe nga OBSH. Faktorët kryesorë janë urbanizimi, aksi kryesor që lidh pjesën veriore të vendit me kryeqytetin dhe ndotja nga djegjet e mbeturinave urbane. Ndotja e rënduar e ajrit vjen kryesisht nga shkarkimet e gazrave dhe të pluhurave, që vijnë si pasojë e aktiviteteve që janë hapur dhe hapen çdo vit, nga industria ndërtimore, nga prishja e ndërtimeve të vjetra dhe e atyre pa leje etj. Po kështu shkarkimi i gazrave në atmosferë, si pasojë e rritjes së numrit të makinave, (kryesisht të vjetra) nga përdoruesit privat, si dhe nga pluhurat e punimeve minerare që i kemi përshkruar më sipër, (të gëlqerorëve, të gurëve dekorativë, atyre ndërtimore), djegjet në natyrë etj.

Gjendja e cilësisë së ajrit është një ndër çështjet mjedisore më kritike, që ka të bëjë me administratorët lokalë dhe autoritetet qendrore, si dhe prek jetën e përditshme të çdo qytetari. Kushtet e jetesës së njeriut janë të varura nga ekosistemi në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme që të mbrojmë dhe të ruajmë mjedisin, në mënyrë që të sigurojmë një kualitet jete të qëndrueshëm, për gjeneratat e së tashmes dhe së ardhmes.

Në përputhje me nenin 7, të ligjit nr. 162/2014, datë 4.12.2014¹², “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, plani i cilësisë së ajrit përgatitet dhe zbatohet, kur nivelet e dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, benzenit, monoksidit të karbonit, plumbit, lëndës së ngurtë pezull ose ozonit në ajrin e mjedisit, kalojnë vlerat kufi apo vlerat e synuara respektive, të përcaktuara sipas nenit 5 të këtij ligji. Gjatë hartimit të planit merret parasysh kufiri përkatës i tolerancës, pavarësisht nëse ka kapërcyer ose jo data e arritjes së vlerës kufi apo vlerës së synuar respektive.

Sipas VKM Nr.412, datë 19.6.2019¹³, në zbatim të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit, ky plan ka dy objektiva:

- 1- Përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonat ku janë tejkaluar limitet e vendosura me ligj, si dhe në zonat ku ekziston një risk i lartë i këtyre tejkalimeve;

¹¹ <https://docslib.org/doc/3347529/plani-operacional-i-zhvillimit-vendor-bashkia-kam%C3%ABz>

¹² https://turizmi.gov.al/ep-content/uploads/2018/09/FZ-198-2014_ligji-162-date-04.12.-2014_-per-mbrojtjen-e-cilesise-se-ajrit-ne-mjedis.pdf

¹³ <https://turizmi.gov.al/cilesia-e-ajrit/>

2- Ruajtjen e nivelit të cilësisë së ajrit në pjesën e ngelur të territorit.

Sipas kësaj VKM, Bashkia e Kamzës ndodhet në Zonën B, e cila kategorizohet nga risku i lartë i tejkalimeve të limiteve të ndotjes, nga të paktën një ndotës.

Cilësia e ajrit bazuar në monitorimet e kryera nga ISHP për rajonin e Kamzës jepet në tabelën më poshtë. Krahasimi është bërë me normën Shqiptare dhe me rekomandimet e OBSH për cilësinë e ajrit¹⁴.

($\mu\text{g}/\text{m}^3$)	LGS	PM10	SO ₂	NO ₂	O ₃	PB
Kamza	235	111	18	30	104	0.32
Norma Shqiptare	140	70	60	60	120	1.0
Vlerat e OBSH	80	50	50	40	110	0.5

Burimi: OBSH

Siç shihet dhe nga tabela më sipër më problematik nga pikëpamja shëndetësore është LGS (që e tejkalon normën tonë me 1.7 herë dhe rekomandimet e OBSH me 3 herë) dhe PM10 (i cili e tejkalon normën tonë me 1.6 herë, ndërsa rekomandimet e OBSH 2.2 herë). Vlerat e elementëve të tjerë (dyoksidit të squfurit, dyoksidit të azotit, ozoni, plumbi) janë brenda kufijëve të përcaktuar.

Ndotja e ajrit në rajonin e Kamzës vjen nga disa faktorë, ndër faktorët më të rëndësishëm, që ndikojnë në ndotjen e ajrit janë:

- Fluksi i madh i lëvizjes së makinave, pasi në këtë rajon kalon aksi kryesor lidhës midis kryeqytetit dhe pjesës veriore të vendit.
- Ndërtimet që deri tani janë bërë pa kriter dhe rregull.
- Djegja e mbeturinave të ngurta urbane nga banorët dhe bizneset.

Zhvillimi urban dhe rural fokusohet në shërbime bujqësore (treg/hapësirë grumbullimi), në industrinë e përpunimit të drurit dhe materialeve të ndërtimit, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qendrave urbane dhe rurale të bashkisë (sistemim dhe shtim të hapësirave të gjelbra dhe publike). Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës parashikon zhvillimin në këtë drejtim nepërmjet krijimit të një qendre multimodale dytësore, stacion autobusësh, taxi/autovetura dhe plotësimin e infrastrukturës me korsi biçiklete.

Sipas Strategjisë Kombëtare të Mjedisit, bashkitë duhet të kryejnë një ndërhyrje efektive në planifikimin urban të zonës administrative, ku të merrret parasysh optimizimi i trafikut, reduktimi i makinave që qarkullojnë, dhe përmirësimi i transportit publik. Sipas treguesve të lartëpërmendur, ndotja e ajrit në bashkinë Kamzë është një problematikë serioze, e cila ngrihet dhe nga Aleanca Feministe Mjedisore Kamzë, ku pas takimeve të zhvilluara kanë

¹⁴ <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf>

evidentuar veshtirësitë që iu shkaktojnë në lëvizje mungesa e linjave efektive të transportit urban.

Aleanca Feministe Mjedisore Kamëz ka shprehur shqetësimin se mungesa e numrit të autobusave në disa linja të Kamzës, respektivisht të linjës Lakinmas – Kamëz, dhe mungesa e një linjë Bathore - Kamëz , iu krijon sfida të mëdha në angazhimin e femrave dhe vajzave në punësim si brënda njësisë administrative, por edhe jashtë saj, duke kufizuar pavarësinë familjare që ato mund të fitojnë.

Mungesa e linjave të transportit, dhe e ndriçimit rrugor natën, nxit përdorimin e shpeshtë autoveturave private dhe kufizon integrimin ekonomik të grave dhe vajzave duke iu kufizuar aksesin në jetën sociale-ekonomike, por gjithashtu duke ndikuar ndjeshëm dhe në cilësinë e ajrit.

Organet e qeverisjes qendrore, së bashku me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin, Inspektoratin përgjegjës për mjedisin dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), sipas aftësive dhe kompetencave të tyre, duhet të aktivizojnë dhe të forcojnë kontrollet mbi shkarkimet nga instalimet industriale, duke vendosur theks të veçantë në monitorimin e instalimeve të Klasës A dhe Klasës B; të përmirësojnë në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e cilësisë së ajrit; të rrisin ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me cilësinë e ajrit, dhe të forcojnë zbatimin e inspektimit dhe programit të kontrollit të shkarkimeve për automjetet motorike

Për bashkitë që përfshihen në zonën B, sipas nivelit të ndotjes së ajrit të përmendur mësipër, parashikohen të ndërmerren në të ardhmen masat e mëposhtme:

- Përtëritja dhe forcimi i mjeteve të transportit publik me ndikim të ulët mjedisor;
- Zhvillimi i iniciativave, me qëllim inkurajimin e përdorimit të transportit publik;
- Nxitja e modernizimit të flotës së automjeteve të kompanive të shërbimeve, me mënyra që i përshtaten standardeve evropiane;
- Të lehtësojë adoptimin e planit të trafikut urban nga bashkitë, që ul trafikun e automjeteve në qendër të bashkisë, adoptim i planit për trafikun e mallrave, për të evituar ose reduktuar lëvizjen e automjeteve të rënda në qendrat urbane.
- Kontrolli i shkarkimeve nga automjetet, dhe largimi nga përdorimi i atyre me shkarkime të tepërta;
- Zbatimi i masave të identifikuar në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Energjitë e Rinovueshme
- Implementimi i skemave efektive të monitorimit, kontrollit dhe raportimit të burimeve të shkarkimeve;
- Forcimi i kapaciteteve monitoruese të AAQ-s, AKMs dhe ARMve;
- Vendosje e shpejtë e standardeve më të shtrënguara të shkarkimeve nga automjetet, me qëllim eliminimin e automjeteve më ndotëse, nëpërmjet përdorimit të taksave të diferencuara.

Gjetjet nga takimet me komunitetin

Gjatë diskutimeve vërehet mungesë e informacionit pasi me fjalën probleme të mjedisit konsiderohet vetëm hedhja apo prezenca e mbeturinave në hapësira të ndryshme publike dhe ndërgjigjesimi komunitar, sa i takon rritjes së edukimit rreth kujdesit për mjedisin, por mungon informacioni në lidhje me energjinë e rinovueshme, shtimin dhe rikuperimin e situatës në pyje, përdorimi i mjeteve motorrike dhe ndotja industriale dhe minerale të cilat në disa raste kanë paraqitur probleme në komunitetin e njësive administrative të Kamzës.

Nevojitet shtimi i koshave të mbetjeve dhe përmirësimi i tyre në disa raste, pasi nga amortizimi rrjedhin, duke ndotur ambientet përreth tyre veçanërisht në verë, ku konsumi është më i lartë dhe temperaturat ndikojnë në aromat e pakëndshme që krijohen. Po ashtu, të klorinohen koshat dhe sipërfaqet rrotull ku janë vendosur koshat.

Në vitin 2022, në bashkëpunim me organizatën jo-fitimprurëse “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, është themeluar, në bashkëpunim me banorë të qytetit të Kamzës dhe organizata lokale, Aleanca Feministe Mjedisore e Kamzës. Gjatë takimeve të zhvilluar në kuadër të Aleancës Feministe Mjedisore, është diskutuar rreth problematikave më të shpeshta që banorët hasin në përditshmërinë e tyre dhe se si këto problematika ndikojnë në mjedis dhe jetën sociale. Anëtarët e Aleancës Feministe Mjedisore ranë në përfundim të disa sfidave aktuale që ata hasin në bashkinë Kamëz dhe paraqiten tek rekomandimet më poshtë.

Fushatat advokuese që po realizohen

Aktualisht, në Bashkinë Kamëz po organizohet një fushatë advokuese mjedisore që po zbatohet për shtimin e koshave të mbetjeve dhe ndriçimin e rrugëve të lagjeve të brendshme të Kamzës.

Konkluzione

Rekomandime - duke u bazuar ne gjetjet por edhe ne rekomandimet e fundit qe ka dhënë BE në progres raport.

Shqipëria dhe Bashkimi Evropian (BE) kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) në Qershor 2006. MSA ka hyrë në fuqi në 1 Prill 2009. Në bazë të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, nenit 108 “Mjedisi” “Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e komunitetit për fushën e mjedisit. Procesi i përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, kryhet në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), në të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) kontribuon për kapitullin 27 të tij “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”.

Më 25 Mars 2020, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së miratoi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Vendimi i Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së u miratua nga Këshilli Evropian më 26 Mars 2020. Këshilli mandatoi Komisionin Evropian për të vazhduar dhe përfunduar procesin e shqyrtimit analitik të acquis së BE-së, duke u nisur nga grupimi i thelbësoreve. Gjatë viteve 2018 dhe 2019, Komisioni Evropian zhvilloi të gjitha takimet shpjeguese të acquis komunitare për të 33 kapitujt.

Takimi shpjegues për kapitullin 27 (“Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”), u zhvillua më 13 -17 Maj 2019, në Bruksel. Në kuadër të përgatitjes për hapjen e negociatave për anëtarësim, qeveria shqiptare po vijon krijimin e strukturës negociuese për negociatat, përfshirë grupet ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, me Nr. 94, datë 20.5.2019, për “Ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian”, për kapitullin 27 “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucion kryesues, për këtë kapitull negociues.

Kapitulli 27 është ndër kapitujt më të rëndësishëm të acquis së BE-së duke përfshirë 73 Direktiva dhe Rregullore, të cilat përbëjnë kuadrin ligjor të BE-së për fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike. Kapitulli 27 është një kapitull ndërsektorial ku përfshihen një sërë ministrish linje dhe agjencish të pavarura, të cilat ushtrojnë kompetenca në fushën e mjedisit dhe nënfushat përkatëse të tij. Të gjitha detyrimet raportuese, planifikimin e politikave, strategjitë si dhe monitorimin e zbatimit të tyre e koordinon MTM në cilësinë e institucionit lider për këtë kapitull. Në bazë të metodologjisë së dakordësuar për punën përgatitore deri në takimet bilaterale, në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të acquis, MTM është në proces vlerësimi të kuadrit ligjor të përafuar me legjislacionin e BE-së për kapitullin 27 dhe kapaciteteve institucionale që rrjedhin si detyrim nga implementimi i këtij kuadri.

Bazuar në sa më sipër, do të ishte e rekomandueshme për Bashkinë Kamëz që:

- Të ndërmerren masa parandaluese për mbrojtjen e mjedisit;
- Të ketë sanksione ndëshkuese kundrejt individëve që kontribuojnë në ndotjen mjedisore;
- Masat sanksionuese do të shërbejnë si një marrje e përgjegjësisë individuale për dëmtimin mjedisor të kryer.
- Shtimi i frekuencës së grumbullimit të mbeturinave me të paktën 2 herë në ditë.
- Planifikimi i një sistemi të ri të vendosjes së pikave të grumbullimit të mbeturinave në bashkinë Kamëz dhe rritja e numrit të tyre.
- Propozimi për shtimin e një pajisjeje alternative “grirëse” për mbetjet, si një mundësi për përpunimin e lëndëve organike, e cila do të kontribuojë në uljen e ndotjes që shkaktojnë mbeturinat.
- Ndriçimi i rrugëve dytësore, dhe të lagjeve, gjatë natës për të mundësuar angazhimin e grave dhe vajzave për një jetë sociale të sigurt.
- Shtimi i numrit të linjave të transportit ndërqytetas, kryesisht me Tiranën, dhe orareve më të shpeshta.
-

Referenca

Bashkia Kamëz – Monitorimi I zbatimit të buxhetit: <https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Raporti-monitorimin-e-zbatimit-te-Buxhetit-per-vitin-2021.pdf>

Bashkia Kamëz – Raporti I Performancës: <https://kamza.gov.al/ep-content/uploads/2022/02/Kamez-Raporti-Performances-2020-draft-2-12-korrik.pdf>

Bashkia Kamëz, faqja zyrtare:

<https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fkamza.gov.al%2Fwp-content%2Fuploads%2F2022%2F10%2FMonitorimi-8-mujori-2022.doc&wdOrigin=BROWSELINK>

Botimet zyrtare: https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/FZ-198-2014_ligji-162-date-04.12.-2014_-per-mbrojtjen-e-cilesise-se-ajrit-ne-mjedis.pdf

Ligji për vetqeverisjen vendore: https://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: <https://turizmi.gov.al/cilesia-e-ajrit/>

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit: <https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/vkm-412-2019-menaxhimi-i-ajrit.pdf>

Plani i përgjithshëm vendor, bashkia Kamëz: https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/VSM_relacioni-paraparak.pdf

Porta vendore: www.portavendore.al